



RAPORT VJETOR

2024

website: www.ikmt.gov.al

Tel: 04 222 39 33

Adresa: Rr. "Muhamet Gjollësia", pranë
Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit

Hyrje

Misioni

Misioni i Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit është ruajtja dhe siguria e ndërtimeve në Republikën e Shqipërisë, duke siguruar respektimin e normave, standardeve, kushteve zhvillimore dhe legjislacionin në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në fushën e mjedisit, pyjeve, burimeve ujore dhe produkteve të ndërtimit, bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, të decentralizmit në bazë të ndarjes administrative.

Vizioni

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit punon për të mbrojtur çdo hapësirë të çmuar të vendit tonë, për të krijuar një mjedis të qëndrueshëm dhe të sigurt.

Historiku

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është institucion qendror buxhetor publik, me statusin e personit juridik, në varësi të Ministrisë së Brendshme. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit drejtohet nga Kryeinspektori, i cili emërohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë e territorit dhe ndërtimeve.

Me ristrukturimin e IKMT-së në përputhje me ndryshimet e VKM, nr. 604, datë 20.10.2021 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme" e ndryshuar, është shtuar fusha e përgjegjësisë së saj në *"parandalimin, mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotje, dëmtime apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji"*. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është tashmë i strukturuar me drejtoritë përkatëse të tij në çdo qark të vendit dhe synon të shtrijë dhe të ketë një ndikim më të madh në territor me qëllim parandalimin dhe minimizimin e ndërtimeve pa leje në territor, parandalimin dhe kontrollin e mjedisit dhe pyjeve nga veprime të kundërligjshme dhe rritja e ndërgjegjësimit për një mjedis më të pastër në interes të të gjithëve.

Baza ligjore

- Ligji Nr.9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.8402, datë 10.09.1998, “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.9290, datë 07.10.2004, “Për Produktet e Ndërtimit”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar,
- Ligji Nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar;
- Ligji 57/2020 “Për Pyjet”;
- Ligji Nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar;
- Ligji Nr.9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin e ujërave të ndotur” i ndryshuar;
- Ligji Nr.8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura” i ndryshuar;
- Ligji Nr.61/2016 “Për Shpalljen e Moratoriumit të Gjuetisë”;
- Ligji Nr.9693, datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10448 date 14.07.2011 " Per Lejet e Mjedisit" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10440 date 07.07.2011 " Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" i ndryshuar;
- VKM Nr.893, datë 4.11.2015 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”, i ndryshuar;
- VKM Nr.894, datë 4.11.2015 “Për Unifikimin e Procedurave të Kontrollit të Territorit nga Inspektorati Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit e ai Vendor”;
- VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar;
- VKM Nr.798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”;
- V.K.M Nr.438, datë 08.06.2016 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e prodhimeve të tjera pyjore dhe jopyjore”;
- Udhëzimit Nr.2, datë 03.03.2017 “Për kërkesa teknike të caktimit të ngastrës dhe grup ngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje”;
- Urdhrit Nr.424, datë 25.11.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”.

IKMT kryen veprimtarinë e saj edhe në bazë të objektivave të vëna në funksion të procesit të qeverisjes qendrore, në drejtim të realizimit të punëve me interes publik dhe çështjeve me rëndësi kombëtare.

Veprimtaria inspektuese e IKMT-së për vitin 2024

Raporti përmbyllës i vitit 2024 përmban të dhënat mbi veprimtarinë inspektuese të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për vitin 2024, përfshirë dhe Drejtoritë Rajonale.

Inspektimet konsistojnë në përmbushjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji Nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.893, datë 4.11.2015 “Për organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.894, datë 4.11.2015 “Për Unifikimin e Proçedurave të Kontrollit të Territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njesisë Vendore”, si edhe veprimtaria inspektuese nga përgjegjësitë e shtuara në fushën e mjedisit, ujërave dhe pyjeve në përputhje me legjislacionin sektorial.

Detyrat dhe Përgjegjësitë e IKMT-së

1. Në përputhje me nenin 9 të ligjit nr. 9780, date 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, nëpërmjet Kryeinspektorit dhe inspektorëve, ushtron këto përgjegjësi:
 - a) Në nivel njësie vendore drejtpërdrejt dhe pa asnjë kufizim për ndërtimet/punimet që lidhen me çështje, zona ose objekte me rëndësi kombëtare dhe në territor (janë zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, monumentet e kulturës, qendrat historike, parqet dhe zonat arkeologjike, pyjet dhe zonat e mbrojtura natyrore, monumentet natyrore, përfshirë zonat me karakteristika unike gjeografike, zonat me rrezik natyror, rrjetet ekologjike, burimet minerare e natyrore dhe rrjetet, komplekset dhe parqet industriale, rrugët kombëtare, linjat hekurudhore dhe infrastruktura ndihmëse, instalimet e infrastrukturës kombëtare, sektori i energjisë dhe komunikimit elektronik, aeroportet, portet e rrugët detare, zhvillimet në zonat ushtarake, vija bregdetare, brigjet dhe burimet ujore, lagunat, lumenjtë, liqenet, digat e

dambat, tokat bujqësore, spitalet publike, objektet dhe terrenet sportive, si dhe ato të përcaktuara me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit e me akte nënligjore ose ligje të tjera);

b) Kontrollon zbatimin e dispozitave të këtij ligji nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të njësisë në nivel të qeverisjes vendore;

c) Kontrollon zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore dhe merr masat përkatëse, sipas dispozitave ligjore përkatëse në fuqi;

ç) Kontrollon përmbushjen e kërkesave ligjore për materialet dhe produktet e ndërtimit që hidhen në treg dhe merr masat përkatëse sipas dispozitave ligjore përkatëse në fuqi;

d) Kontrollon përmbushjen e kërkesave ligjore për shfrytëzimin e karriera të nxjerrjes së materialeve të ndërtimit dhe për pusët e ujit dhe merr masat përkatëse sipas dispozitave ligjore përkatëse në fuqi;

dh) Ushtron përgjegjësitë e parashikuara shprehimisht në ligje të tjera.

2. Në përputhje me VKM nr. 502 datë 13.09.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme" e ndryshuar, duke shtuar në fushat e përgjegjësisë së saj *“Parandalimin, mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotje, dëmtime apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji”*.

Qëllimi

1. Rritja e performancës në drejtim të mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e kundërligjshme dhe në fusha të tjera inspektuese të mjedisit, pyjeve dhe ujërave;
2. Mbikëqyrja e zonave me qëllim parandalimin e punimeve/ndërtimeve të paligjshme, kryesisht në zonat e mbrojtura, të infrastrukturës publike, zonave bregdetare dhe liqenore etj;
3. Realizimi me korrektësi të inspektimeve sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore dhe programeve të miratuara në nivel qendror edhe në fushën e shtuar të përgjegjësisë të IKMT-së;
4. Mundësimin e zgjidhjeve sa më efektive për të shmangur sa më shumë pasojat e zhvillimeve të paligjshme në territor;
5. Dhënia dhe përpunimi i informacionit në kohë sa më të saktë për vendimmarrësit.

6. Mbikëqyrja me instrumentat që disponohet sipas strukturës së miratuar, për kryerjen e inspektimeve me korrektësi.

Struktura dhe funksioni

IKMT ka Drejtorinë qendrore në Tiranë dhe shtrin juridiksionin territorial nëpërmjet Drejtorive rajonale në të gjitha qarqet e vendit.

IKMT drejtohet nga Kryeinspektori, i mbështetur nga zv. Kryeinspektori, dhe ka në përbërje të tij këto drejtori:

- **Drejtoria e Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit**, është përgjegjëse për zbatimin e ligjshmërisë në respektimin e normave dhe standardeve në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit e disiplinimit të punimeve në ndërtim, menaxhimit të integruar të burimeve ujore, mbikëqyrjen dhe kontrollin ndaj inspektorateve të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në nivel qarku, inspektimin e materialeve dhe produkteve të ndërtimit që hidhen në treg, inspektimin e shfrytëzimit të karrierave të nxjerrjes së materialeve të ndërtimit;
- **Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave**, përgjegjëse për zbatimin e ligjshmërisë në respektimin e normave dhe standardeve në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së mjedisit dhe burimeve ujore, menaxhimit të integruar të burimeve ujore, mbikëqyrjen dhe kontrollin e shfrytëzimit të karrierave të nxjerrjes së materialeve të ndërtimit dhe për pusët e ujit;
- **Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve**, mbulon veprimtarinë për ushtrimin e përgjegjësisë të inspektimit dhe zbatimin e ligjshmërisë në këto drejtime. Të garantojë mbrojtjen dhe sigurinë e pyjeve përmes parandalimit, zbulimit dhe hetimit të veprave penale kundër pyjeve dhe procedimit pyjor të autorëve të tyre në përputhje me parashikimet e legjislacionit penal. Bashkëpunon me strukturat përgjegjëse për kontrollin në pyje sipas ligjit përkatës dhe mbështetin ato sipas kërkesës dhe nevojës.
- **Drejtoria e Informacionit dhe Kontrollit të të Dhënave dhe Marëdhënieve me Publikun**, është përgjegjëse për mbarëvajtjen e veprimtarisë së institucionit si dhe të grumbullimit, përpunimit dhe koordinimit të veprimarisë së aktivitetit të këtij institucioni

me institucione të tjera ligjzbatuese e konstatuese. Mbledh informacion në mënyrë të vazhdueshme nga të gjitha drejtoritë e tjera dhe prodhon raporte periodike në mbështetje të analizës së plotë të punës së IKMT-së, ofron informacion për publikun dhe institucione të tjera publike apo të huaja sipas kërkesave të marra. Mbështet politikat/aktivitetet sensibilizuese të IKMT-së për mbrojtjen e mjedisit dhe territorit.

- **Drejtoria e Inspektimit Juridik**, ka mision të rregullojë dhe të kryejë të gjithë veprimtarinë juridike dhe legislative në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, përmirësimin e kuadrit ligjor përkatës si edhe përfaqësimin juridik të institucionit në proçese gjyqësore dhe marrëdhënie me të tretët;
- **Drejtoria e Zbatimit të Vendimeve**, përgjegjëse për organizimin në aspektin praktik të ndërhyrjeve në terren, për zbatimin e vendimeve të IKMT me objekt: pezullimin e punimeve të ndërtimit, prishjen e ndërtimeve të paligjshme, sekuestrimin e mjeteve të punës dhe makinerive etj.
- **Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse**, përgjegjëse për mbarëvajtjen e veprimtarisë së institucionit në aspektin administrativ dhe financiar.
- **Drejtoritë rajonale të IKMT-së** e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin rajonal përkatës dhe janë përgjegjëse për inspektimin në atë rajon.

Fig.1 Organigrama e IKMT-së



1. VENDIMET E MBAJTURA

1.1 Informacion mbi vendimet e mbajtura nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

Gjatë vitit 2024, IKMT-ja ka mbajtur këto vendime:

- **427** Objekte/ndërtime të prishura, të cilat janë ndërtuar në kundërshtim me ligjin /VKM shpronësimi.
- **261** Vendime për dënim me gjobë të vëna në fushën e ndërtimeve pa leje;
- **159** Vendime për dënim me gjobë të vëna në fushën e mjedisit/ujërave dhe **2** vendime për dënim me gjobë të vëna në fushën pyjeve;
- **6** Vendime për dënim me gjobë të vëna mbi zbatimin e ligjshmërisë tek produktet e ndërtimit/burimet ujore;
- **19** Vendime për dënim me gjobë të vëna ndaj Kryeinspektorëve/inspektorëve pranë IMT-ve të bashkive për veprime/mosveprimet e tyre;




Fig. 2: Paraqitja grafike e vendimeve të marra nga IKMT - ja, për vitin 2024

2. INSPEKTIMET E REALIZUARA

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Drejtoritë Rajonale, kanë qenë të angazhuara në të gjithë territorin e vendit për kryerjen e kontrolleve dhe inspektimeve sipas fushës së përgjegjësisë dhe kuadrit ligjor.

- Janë kryer gjithsej **7916 inspektime**




Fig. 3: Vijueshmëria e inspektimeve të realizuara nga IKMT përfshirë Drejtoritë Rajonale), për vitin 2024
Burimi: IKMT




Fig.4 Grafiku i inspektimeve për vitet 2023 - 2024 Burimi:IKMT

2.1 Informacion mbi korrespondencën zyrtare

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka vijuar procedurat dhe veprimtarinë e tij administrative në përputhje me kuadrin ligjor, si rezultat kemi:

- Është kryer trajtimi shkresor i **9543 ankesave/shkresave** (këto të reja dhe në vazhdim), për kthimin e përgjigjeve të ankesave / kërkesave të paraqitura si dhe vënien në dispozicion të informacionit për institucione dhe individëve kërkuar.
- Nga Platforma e Bashkëqeverisjes, “Shqipëria që duam” janë trajtuar **141 ankesa** në total.




Fig. 5 Ankesa / shkresa dhe Platforma “Shqipëria që duam” Burimi: IKMT

3. PUNA E REALIZUAR NGA DREJTORITË RAJONALE TË IKMT - SË

Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoritë Rajonale të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, janë realizuar gjithsej **6436 inspektime** nga ku:

- **2174** Inspektime janë realizuar në Fushën e Mjedisit dhe Burimeve Ujore;
- **2151** Inspektime janë realizuar në Fushën e Ndërtimit;
- **1623** Inspektime janë realizuar në Pyje;
- **298** Inspektime në bashkëpunim me Policinë e Shtetit;
- **190** Monitorime në shkolla.

Nga Drejtoritë Rajonale të IKMT - së, është kryer trajtimi shkresor i **4314 ankesave / shkresave** (këto të reja dhe në vazhdim), për kthimin e përgjigjeve të ankesave/kërkesave të paraqitura si dhe vënien në dispozicion të informacionit për institucione dhe individëve kërkuar. Nga paraqitja grafike vihet re një rritje e numrit të shkresave për vitin 2024.




Fig. 6 Grafiku i shkresave /ankesave nga DRIKMT Burimi: DRIKMT

4. PUNË TË REALIZUARA NË VIJËN BREGDETARE

Operacioni “Bregdeti ynë” i ndërmarrë nga IKMT në bashkëpunim me Policinë e Shtetit ka në fokus të tij lirimimin e hapësirave publike, të zaptuara pa leje nga pronarë subjektsh që operojnë përgjatë vijës bregdetare në vendin tonë.

Në kuadër të këtij aksioni janë kryer inspektime në terren në të gjitha stukturat e ngritura përgjatë bregdetit, në total janë kryer **84 prishje** si më poshtë vijon:

- Bashkia Himarë (në plazhin e Dhërmiut, Drimadhas, plazhi Gjipe, Qeparo dhe Borsh);
- Bashkia Sarandë (në plazhin e Lukovës dhe Ksamilit);
- Bashkia Shkodër (zona përendimore e liqenit)

5. PROJEKTE MADHORE INFRASTRUKTURORE

5.1 Punë të realizuara për projektet infrastrukturore:

Përveç inspektimeve të realizuara në territor, në përputhje me përcaktimet ligjore sipas fushës së vet të përgjegjësisë, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka ndërmarrë veprime në kuadër të zbatimit të projekteve madhore të Qeverisë Shqiptare, në projektet që janë cilësuar më poshtë:

A. Projekti Infrastrukturor “Unaza e madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri Shkozë, Segmentit rrugor “Thumanë - Vorë Kashar” .

Në vijim të projektit “Rishikimi i Projektit për Segmentin Rrugor të vazhdimet Unaza e Madhe Tiranë nga “Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri” dhe rikualifikimi i Unazës Lindore për Lotet 4,5,6 të ndryshuar është realizuar prishja e **103** objekteve nga 1 deri 6 kat. të trajtuara me VKM shpronësimi , me VKM 409 (akt marrëveshje) dhe me vendime prishje të marra nga IKMT ja.

Në vijim të projektit segmentit rrugor “Thumanë - Vorë Kashar” është realizuar prishja e **82** objekteve nga 1 deri 4 kat. të trajtuara me VKM shpronësimi, me VKM 409 (akt marrëveshje) dhe me vendime prishje të marra nga IKMT-ja .

Aktualisht, vazhdon puna nëpërmjet një sfide të re për shembjen e objekteve të ngritura në shkelje flagrante të ligjit, të cilët pengojnë zhvillimin e mëtejshëm të kësaj vepre të madhe infrastrukturore.

B. Realizimi i projekteve kombëtare

Në vijim të projektit “Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregdetit perëndimor të Liqenit të Shkodrës”:

- Kemi realizuar prishjen e **10** objekteve me vendim prishje të dal nga IKMT-ja.




Fig. 7 Objekte të prishura me VKM për vitin 2024

Burimi: IKMT

5.2 Prishjet në total të realizuara nga IKMT - ja, gjatë vitit 2024

Gjatë vitit 2024 nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është ndërhyrë në mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme si më poshtë vijon:

- **427** Objekte/ndërtime të prishura, të cilat janë ndërtuar në kundërshtim me ligjin / VKM shpronësimi.
- **356** Vendim prishje/pezullim të objekteve të kundraligjshme/pezullimi të punimeve në ndërtim.




Fig.8 Paraqitja grafike e prishjeve në total, viti 2024
Burimi: IKMT

6. DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË TERRITORIT

Sa i takon zbatueshmërisë së legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e territorit nga kjo drejtori, inspektimet e ushtruara përkatësisht kanë për qëllim:

Parandalimi, zbulimi dhe goditja e veprimtarisë së paligjshmërisë për çdo ndërtim në shkelje të kushteve të zbatimit të ligjit të urbanistikës;

Mbajtja nën mbikëqyrje dhe inspektimi i subjekteve fizike dhe juridike që ushtrojnë aktivitetin e tyre në prodhimin dhe tregtimin e produkteve të materialeve të ndërtimit;

Inspektimet mbi zbatimin e dispozitave ligjore nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të Njësive në nivel të qeverisjes vendore;

Mbikëqyrja me qëllim kontrollin për njohjen dhe zbatimin e ligjit nga Drejtoritë Rajonale;

Rritja e bashkëpunimit për goditjen e paligjshmërisë duke rritur bashkëpunimin me institucionet e tjera;

Informimi në kohë, sanksionimi dhe vendimmarrja për subjektet që operojnë në mënyrë të kundërligjshme;

Në total nga Drejtoria e Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit janë mbajtur vendimet si më poshtë:

- **283 vendime për “Prishje objekti të kundërligjshëm”.**
- **40 vendime për “Pezullimin e punimeve në ndërtim”;**
- **262 vendime për “Dënim me gjobë”** të vëna në fushën e ndërtimeve pa leje dhe në fushën e prodhimit dhe tregtimit të materialeve dhe produkteve të ndërtimit ;
- **23 vendime për “Dënim me gjobë”** të vëna ndaj kryeinspektorëve/inspektorëve pranë IMT-ve të bashkive për veprimet/mosveprimet e tyre;
- **1812 shkresa** të mbajtura nga kjo drejtori.

7. DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË MJEDISIT DHE UJËRAVE

Sa i takon zbatueshmërisë së legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe ujërave, inspektimet e ushtruara nga drejtoria përkatëse kanë për qëllim kryesisht:

- Zbatueshmëria e legjislacionit në fuqi sa i takon ligjit 10448 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, me qëllim parandalimin e ushtrimit të aktivitetit nga subjektet pa leje mjedisore përkatëse apo në shkelje të kushteve të lejes mjedisore. Njëkohësisht zbatueshmëria e ligjit 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” i ndryshuar, për të parandaluar shfrytëzimin e burimeve ujore pa leje përkatëse nga institucioni kompetent apo në kundërshtim me kushtet e lejes që subjekti disponon. Njëkohësisht mbrojtjen e mjedisit nga dëmi që mund të vijë si pasojë e ushtrimit të aktivitetit nga subjektet që paraqesin rrezikshmëri të mundshme ndotjes të tokës, ujit apo ajrit, si dhe nga aktiviteti i subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në industrinë nxjerrëse (përfshirë atë minerare si dhe nëntokësore apo në qiell të hapur) me qëllim zbatimin e ligjit 10463 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar. Synimi primar mbetet gjithnjë parandalimi dhe ndëshkimi i subjekteve që çenojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mjedisin, ajrin apo burimet ujore.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024, nga Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave janë mbajtur:

- **283 inspektime** në fushën e mjedisit;
- **159 masa administrative** vendime “Dënim me gjobë”.
- **492 shkresa** të mbajtura nga kjo drejtori.

8. DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË PYJEVE

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është fokusuar në zbatimin e ligjshmërisë në fondin pyjor, kullosor, mbrojtjen e pyjeve nga dëmtimet, prerjet, zëniet e përdorimet e paligjshme të fondit pyjor e kullosor, zjarret, mbrojtjen e faunës së egër, zbatimin e moratoriumit në gjueti, pyje dhe bimëve medicinale etanifere;

Pranë Drejtorisë së Inspektimit të Pyjeve është bërë në vazhdimësi grumbullimi, përpunimi dhe analiza e plotë e të dhënave për të gjithë aktivitetet e kundërvajtjeve në pyje, kullota e në gjueti në nivel qarku e rang kombëtar. Raportet e analizës së të dhënave janë përpunuar dhe janë dërguar në Kryeministri, ministri dhe institucionet e tjera të përfshira në proces;

Nga grupet e Inspektimit të Drejtorisë së Inspektimit të Pyjeve janë ushtruar kontrolle në Drejtoritë Rajonale të IKMT-ve ku në raportet e hartuara është bërë vlerësimi i situatës dhe rakordimet e nevojshme për zgjidhjen e problemeve;

Janë verifikuar ankesa të ardhura nga qytetarë, protokolluar pranë institucionit tonë si dhe ankesa të ardhura në portalet qeveritare që kanë lidhje me shkeljen në pyje, kullota, gjueti etj; Në zbatim të Udhëzimit Nr.161, datë 23.06.2020, të Ministrit të Brendshëm “Për procedurat e veprimit të përbashkët të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit me Policinë e Shtetit”, për kontrollin e transportit të paligjshëm të materialit drusor si dhe janë ngritur në bashkëpunim postoblloqe fikse e të lëvizshme.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024, nga Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve janë mbajtur:

- **110 inspektime** në fushën e mjedisit;
- **2 masa administrative** vendime “Dënim me gjobë”;
- **212 shkresa** të mbajtura nga kjo drejtori.




Fig.9 Inspektimet në rang kombëtar, 2024

Zjarret dhe emergjencat

Drejtoria e Inspektimit të pyjeve nuk ka patur kërkesë për mbështetje shtesë në rastet e rënies së zjarreve, duke qenë se dhe kompetencat i kanë patur vetë Bashkitë, Administratat Rajonale të Zonave të mbrojtura si dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve, por që kemi patur raste sporadike nga disa prej Drejtorive Rajonale, si më poshtë vijon :

Tabela e zjarreve në Republikën e Shqipërisë.

Nr	Drejt oritë Rajo nale	Nu mri i ras teve	Siper faqja e përsh kruar / ha	Sipërfaqja e djegur / ha	Pron ësia	Inspek time/ Subjek te të Inspek tuar	Mjete të ndalua ra	Bashk ëpuni me me Policin ë e Shtetit	Inspek time në Gjueti	Prok urori	Mate rial druso r i Sekue struar (raste)
			Pyje	Kullota	Pyje						-
1	Tiranë		61			34	34	1	-		-
2	Kukës	26	565,99		565.99	21	0	21	32		-
3	Berat	-	-	-	-	-			-		-
4	Dibër	9	876.1			78	-	17	-	-	2
5	Durrës	-	-	-	-	-	-	27	15	2	2
6	Elbasan	-	-	-	-	164		1	47		-
7	Shkodër		3640	-	79	85	-	-	-	-	-
8	Vlorë		745	-		4	-	-	-	-	-
9	Lezhë			-			-	-	-	-	-
10	Fier			-			-	-	-	-	-
11	Korçë	9	2947.18	-	-	-	-	4	-	4	2
12	Gjirokastrë	4	1223	-	-	-	-	-	-	-	-

9. DREJTORIA E INSPEKTIMIT JURIDIK

IKMT duhet të garantojë parandalimin e çdo forme ndërtimi pa leje, mbrojtjen e mjedisit nga çdo lloj ndotësi dhe mbrojtjen e pyjeve nga shkelësit e ligjit dhe mbi të gjitha ndëshkim penal të kundërvajtësve. Për periudhën janar - dhjetor 2024 janë dërguar:

- **2 Kallëzime** penale;
- **1351 Shkresa** të mbajtura gjatë vitit nga kjo drejtori.

10. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) ka intensifikuar bashkëpunimin me Policinë e Shtetit për të përmbushur detyrimet e tij në mbrojtjen e mjedisit nga krimet mjedisore, bazuar në Udhëzimin nr. 161, datë 23.06.2020, të Ministrit të Brendshëm, "Për procedurat e veprimit të përbashkët të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit me Policinë e Shtetit."

Në kuadër të urdhrat të përbashkët ndërinstytucional nr. 1727, datë 26.11.2021, "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektit teknik dhe dokumentacionit të nevojshëm për realizimin e projektit të monitorimit të territorit me teknologji të avancuar," IKMT ka kontribuar në hartimin e projektit teknik për përdorimin e informacionit satelitor, duke synuar rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe fuqizimin e kontrollit mbi territorin.

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2024, janë realizuar **326 inspekte** në bashkëpunim me Policinë e Shtetit.

11. SFIDAT DHE PRITSHMËRITË

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është një institucion me një histori të gjatë shifrash dhe aksionesh në parandalimin e ndërtimeve pa leje dhe në çlirimin e hapësirave publike.

Vija Bregdetare:

Evidentimi, procedimi dhe prishja e ndërtimeve pa leje / me leje (pas trajtimit sipas legjislacionit) konkretisht:

- Në zona të brezit të zhvillimit të kontrolluar dhe zonave me përparësi të turizmit.
- Ndërhyrja ndaj ndërtimeve pengesë për zhvillimet e projekteve me interes publik.

Mbrojtja e territorit nga krimi mjedisor:

Mbetet një sfidë e përhershme për institucionin tonë. Përveç aplikimit të masave administrative ndaj subjekteve të konstatuara në shkelje, bashkëpunimi për procedimin penal të kundërvajtësve vijon pa ndërprerje. IKMT ka përgatitur një plan të detajuar veprimi për lirim të hapësirave publike, i cili do të zbatohet me intensitet të lartë edhe gjatë vitit 2025:

- Kontrolli dhe mbrojtja e territorit përbëjnë prioritetin kryesor për IKMT-në;
- Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe social nuk mund të arrihet pa një qasje të rregullt dhe të kontrolluar ndaj ndërtimeve.

Tolerancë zero ndaj krimit mjedisor.

Digjitalizimi:

Përqafimi i një qasjeje më të gjerë ndaj digjitalizimit dhe informatizimit të shërbimeve online, duke mundësuar kontroll më të detajuar të territorit, parandalimin e ndërtimeve pa leje dhe lirim të hapësirave publike të zëna në mënyrë të paligjshme;

Bashkëpunimi i ngushtë midis IKMT-së, Policisë së Shtetit dhe qytetarëve.